

VENDIM
Nr.83, datë 13.12.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.44, DATË 8.6.2005 TË KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË “PËR MIRATIMIN E SISTEMIT
RAPORTUES PËR SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË
TYRE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 27 dhe të nenit 43 germa “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 47 pika 3 të ligjit nr.8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Statistikave, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.44, datë 8.6.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e sistemit raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) në pikën 1, germa “a” “Raportime nga unionet për aktivitetin e tyre” dhe germa “c” “Raportime nga unionet me të dhëna individuale për çdo shoqëri kursim-krediti, formulari nr.6 “Likuiditeti”, ndryshon sipas formatit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

SISTEMI RAPORTUES I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE

Formulari nr.6

Nr.	Likuiditeti	Norma e lejuar	Në mijë lekë	Në %
			Shuma	Raportet e mbikëqyrjes
1	Gjendja e arkës			
2	Llogaritë rrjedhëse			
3	Depozitat me afat maturimi mbetës deri në 1 muaj			
4	Totali (1+2+3)			
5	Totali i depozitave të lira me afat maturimi jo më të madh se 6 muaj			
	Raporti 4 / 5 *100	jo më e vogël se 10%		#DIV/0!
1	Kredi me afat mbi 5 vjet			
2	Kapitali (pas zbritjes së aktiveve fikse)			
	Raporti 1 / 2 * 100	jo më e madhe se 100%		#DIV/0!
3	Totali i depozitave			
	Raporti 1 / 3 * 100	jo më e madhe se 10%		#DIV/0!
4	Detyrime me afat mbi 5 vjet			
	Raporti 1 / 4 *100	jo më e madhe se 100%		#DIV/0!
5	Kredi me afat mbi 10 vjet			
6	Kredi me afat mbi 5 vjet në dy vitet e para			

7	Totali i kredive mbi 7 vjet të pagarantuar		
---	--	--	--

* Përfshihen kreditë e dhëna me një afat mbi 7 vjet të pagarantuar me kolateralet e specifikuar në pikën 8.5 të nenit 8 të rregullores "Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren "Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr.65, datë 29.9.2010.